



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 802/4 Prot.

Vlorë më, 14.05. 2021

VENDIM

Nr. 20, datë 11. 05. 2021

PËR PAGESËN E ANËTARËVE TË GRUPEVE TË PUNËS PËR APLIKIM DHE SHKRIM PROJEKTESH

Në mbështetje të nenit 49, pika 1 gërma ë, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 29, datë 10. 09. 2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me shkresën nr. 593/ 3 prot, datë 20. 04. 2021, shkresën nr. 580, datë 07. 04. 2021, në mbledhjen e datës 11. 05. 2021 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e grupeve të punës për shkrim projektsh sipas shkresave nr. 593/3 prot, datë 20. 04. 2021 shkresën nr. 580, datë 07. 04. 2021, në respektim të orëve të lejuara në Udhëzimin nr. 29, datë 10. 09. 2018.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. ERVIS MOÇKA

